



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.827/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc.Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Nurijs Cacaj, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Deçan, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e paneli të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë,

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i Nurijs Cacaj, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Deçan, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK), me shenjë ZL.Anr.827/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.827/2017 me datën 10.11.2017 në ora 09:25, nga parashtruesja Nurijs Cacaj, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Deçan, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK), në të cilën pretendohet se në QV 0101X në Carrabreg, QV 0101C në Gjimnaz, QV 0102c Dranovc, QV 0103C në Gramaqel, QV 0104C në Prapaqan, QV 0105C në Strelle, QV 0106C në Irznqi, QV 0107C Gllogjan, QV 0108C Isniq, 0103c në Beleg, QV 0110C në Lumbardh, QV 0111C në Prilep, QV 0112C në Rastavicë dhe QV 0114C në Strelle i mungojnë votat.

Parashtruesja e apelit si provë nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimit në apelin e parashtruar gjeti se ankuesja me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet në të cilat pretendon se ka pasur parregullsi. Prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.827/2017 më datën 11.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Dr.sc Rafet Haxhaj



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*